

VENDIM
Nr. 160, datë 6.10.2016

**MBI PËRJASHTIMIN E KLIENTËVE FUNDORË QË FURNIZOHEN NGA
SHËRBIMI UNIVERSAL NGA PËRGJEGJËSIA PËR DISBALANCAT**

Në mbështetje të neneve 16; 81, pika 2, dhe 109, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, datë 31.4.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me përjashtimin e klientëve fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal nga përgjegjësia për disbalancat kundrejt këtij të fundit,

konstatoi se:

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në pikën 2, të nenit 81, pika 2, sjell një nga rrethanat përjashtimore, sa i përket trajtimit të disbalancave, duke parashikuar se: ERE-ja vendos përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat, për kategori të caktuara të klientëve fundorë, të cilët furnizohen mbi bazën e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat për klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në kuptim të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a. dhe Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti